



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

07 Nr. 320-4655/21

Klinë, më 09.02.2021

Projekt për përkrahjen në zhvillimin e pemëtarisë, perimtarisë dhe blegtorisë.

Komuna e Klinës – Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim të përkrahjes dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë - pemëtarisë, perimtarisë dhe blegtorisë, bën :

THIRRJE PUBLIKE

Fton fermerët e interesuar të aplikojnë në projekt për përkrahjen dhe zhvillimin e pemëtarisë, perimtarisë dhe blegtorisë - furnizim me :

1. Makinë mjelëse të lopëve, deleve, dhive; dhe
2. Spërkatëse krahu.

1. Kriteret e konkurrimit për makinën mjelëse të lopëve, deleve dhe dhive:

1. Fermeri duhet të jetë banorë i Komunës së Klinës;
2. Të merret me kultivimin e Blegtorisë;
3. Të posedon se paku 2 krerë lopë të mbarsura (qumështore) apo 15 krerë dele, dhi të mbarsura;
4. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar asnjëherë nga projektet e Drejtorisë së Bujqësisë.

2. Kriteret e konkurrimit për spërkatëse krahu:

1. Fermeri duhet të jetë banorë i Komunës së Klinës;
2. Të merret me kultivimin e kulturave të Perimtarisë, Pemëtarisë apo vreshtarisë;
3. Përparësi kanë fermerët, të cilët nuk kanë përfituar asnjëherë nga projektet e Drejtorisë së Bujqësisë.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e shkruar nga vetë fermeri, (merret në zyrën e shërbimeve për qytetar në objektin e Komunës);
2. Kopja e letërnjoftimit;
3. Kopja e certifikatës së NIF-it;

Afati i aplikimit nga data 09.02.2021 deri me 19.02.2021

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën e shërbimeve për qytetar (arkivit) në hyrje të objektit të komunës. Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.



Drejtori i Drejtorisë së BPZH